



## Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

### Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS							
<b>Niveli i studimeve</b>	Bachelor	<b>Programi</b>	Gjuhë dhe letërsi shqipe	<b>Viti akademik</b>	2020/21		
<b>LËNDA</b>		<b>Letërsi romantike shqipe II</b>					
<b>Viti</b>	II	<b>Statusi i lëndës</b>	Obligative	<b>Kodi</b>		<b>ECTS kredi</b>	<b>6</b>
<b>Semestri</b>	veror						
<b>Javët mësimore</b>	15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtrime	
					3	2	
<b>Metodologjia e mësimi</b>	Romantizmi fillon në vitet 30-40 të shekullit XIX dhe vazhdon deri në shpalljen e Pavarësisë. Konceptet dhe fenomenet e formacionit stilistik të Romantizmit në letërsinë shqipe janë objekt studimi në lëndën Letërsia romantike shqipe II. Aspekti teoriko-kritik dhe analiza letrare përqendrohet tek autorët emblematikë dhe tek veprat e tyre.						
<b>Konsultime</b>							
<b>Mësimdhënësi</b>	Prof.asoc.dr. Teuta Vinca Kafexholli			e-mail	<a href="mailto:teuta.kafexholli@uni-prizren.com">teuta.kafexholli@uni-prizren.com</a>		
				Tel.	045 405 444		

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p><b>Qëllimi i kursit Histori e letërsisë shqipe II – Romantizëm është që studenti:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të fitojë njohuri të duhura dhe sistematike për modelin kulturor të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.</li> <li>- të ketë informacion për poetikën dhe strukturën e zhvillimit të formacionit stilistik të Romantizmit.</li> <li>- të hartojë me kreativitet vështrimet dhe trajtesat e tij individuale që kanë të bëjnë me vepra të veçanta dhe fenomene të përgjithshme të romantizmit shqiptar.</li> </ul>	<p><b>Studenti do të jenë në gjendje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të bëjë krahasime në fushën e studimit midis romantizmit evropian dhe romantizmit shqiptar, duke u nisur nga idetë, temat, kodet, ligjërimet, figurat, stilet etj.</li> <li>- të komunikojë qartë me përbërësit e shkrimit romantik dhe me kritikën letrare për të.</li> <li>- të sistemojë konceptin dhe metodën e kërkimit të esencave në kuptimin letrar dhe në nivelin shkencor.</li> <li>- të zotërojë dijet më të avancuara për të dhënë vlerësime të pavarura, në të shkruar dhe në të folur.</li> </ul>

<b>Metodologjia për realizimin e temave mësimore:</b>
Ligjëratat do të organizohen në modelin ndërvepruese apo të kombinuar si: shpjegim – sqarim, ushtrime, analiza tekstore e shkencore, diskutime, punë në grupe, demonstrime dhe interpretime, shtruarje e shqyrtime idesh, hartime krijuese e vetëhulumtuese etj. Këto do të jenë pjesë kryesore për punën e vlerësimit dhe mënyrën apo metodologjinë e të ligjruarit.
<b>Kushtet për realizimin e temës mësimore:</b>

Klasa, tabela, projektor, kompjuter, shkurtes e marker, materiale të fotokopjuara etj.			
<b>Mënyra e vlerësimit të studentit ( në%)</b>			
<p>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në, vlerësimet me shkrim (dy teste gjatë vitit akademik), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.</p> <p><b>Pikët e vlerësimit:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Testi i parë: 15 pikë</li> <li>2. Testi i dytë: 15 pikë</li> <li>3. Punim seminari 10 pikë</li> <li>4. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë</li> <li>5. Vlerësimi i fundit testi përfundimtar 50 pikë.</li> <li>6. Totali: 100 pikë</li> </ol>	<b>Vlerësimi në %</b>	<b>Nota përfundimtare</b>	
			<p>Vlerat e pikëve:</p> <p>51-60 = 6 61-70 = 7 71-80 = 8 81-90 = 9 91-100 = 10</p> <p>Studentët me rezultat të përgjithshëm nën 50 pikë nuk mbërrijnë notën kaluese.</p>
<b>Ligjërata</b>		<b>Ushtrime</b>	
<p>Në ligjërata studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktiv, të kompletuar dhe të përgatitur me pajisje mësimore, dhe studimore për ta kuptuar dhe realizuar temën e dëgjuar apo plan-programin e lëndës.</p>		<p>Brenda orëve të ushtrimeve dhe me metoda ndërvepruese do të ketë pjesë të ushtrimeve për qartësi më të madhe që kanë të bëjnë me lëndën Histori e letërsisë shqipe II –Romantizëm</p>	
<b>Ngarkesa e studentit për lëndën</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej:</b>
Ligjërata	3	15	45
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1	15	15
Seminare, teste, kolokfiume etj.	4	2	8
Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1	3
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, në provim final)	4	2	8
Projekte, prezantimet etj.	1	3	3
<b>Vërejtje: 1 ECTS krediç25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë</b>		<b>Ngarkesa totale:</b>	<b>150</b>

Java	<b>Ligjërata</b>	
1.	<b>Tema</b>	<b>Orët</b>
	<p><b>Hyrje në lëndën e Historisë së letërsisë shqipe II</b> Përmbledhje e lëndës; Konteksti historik dhe konteksti kulturor në periudhën e Rilindjes Kombëtare;</p>	3
2.	<p><b>Romantizmi shqiptar dhe romantizmi evropian;</b> Historia dhe bashkëkohësia; Kulti i ardhmërisë; Romantizmi dhe klasicizmi; Bota njerëzore dhe bota imagjinare; Konteksti horizontal evropian i romantizmit shqiptar.</p>	3

3.	<b>Gavrill Dara i Riu</b> Fillimet poetike; Poema “Kënga e Sprasme e Balës” dhe historia e letërsisë; Poema dhe kujtesa historike; Ndërtimi tematik.	3
4.	<b>Konstandin Kristoforidhi</b> Romantiku polyglot; Baba i gjuhës shqipe; Përkthimet e librave të shenjtë; Dialektet dhe gjuha gjithëkombëtare; Fjalori i gjuhës shqipe; Kallëzimi “Gjahu i malësorëve- Hieja e Tomorrit”.	3
5.	<b>Zef Serembe</b> Shkrimet e botuara e të pabotuara; Poemat italisht; Qëndrimi ndaj poezisë popullore; Qëndrimi ndaj poezisë evropiane; Qëndrimi ndaj gjuhës.	3
6.	<b>Naim Frashëri</b> <i>Naimi dhe tradita letrare kombëtare e botërore;</i> <i>Naimi dhe tradita letrare kombëtare e botërore</i> <i>Naimi dhe letërsia e Lindjes;</i> <i>Proza diturore dhe filozofike;</i> <i>Proza dhe poezia për fëmijë;</i> <i>Poezia diturore;</i> <i>Vjershat dhe poemat atdhetare.</i> <i>Analizë e veprës “Lulet e verës”</i>	3
7.	<b>Naim Frashëri</b> <i>Poema “Bagëti e bujqësija”;</i> <i>Ndërtimi tematik i poemës;</i> <i>Vjershat dhe poemat filozofike;</i> <i>Poema “Historia e Skënderbeut”;</i> <i>Ndërtimi i personazheve të “Historia e Skënderbeut”;</i> <i>Vlera artistike e poemës;</i> <i>Rëndësia e krijmtarisë gjuhësore të Naimit për gjuhën gjithëkombëtare.</i>	3
8.	<b>Sami Frashëri</b> Jeta dhe botëkuptimi; Sami Frashëri dhe kultura turke; Sami Frashëri në letërsinë e romantizmit shqiptar; Analizë e dramës “Besa”; Ndërtimi melodramatik të drama “Besa”; Proza historike dhe kompozicioni i veprës “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?”; Analizë e romanit “Dashuria e Talatit me Fitneten”; Gjuha diturore dhe gjuha artistike letrare.	3
9.	<b>Provimi i parë gjysmësemestral</b>	3
10.	<b>Filip Shiroka</b> Kronologji e jetës; Vjershëtor i vonuar; Poezitë atdhetare; Poezitë satirike;	

	Poezitë meditative; Prirje të stilit Vjershat e tij dhe horizonti i pritjes.	
11.	<b>Ndre Mjeda</b> Mes traditës botërore dhe traditës kombëtare; Fillimet krijuese; Poemat lirike; Poema “Vaji i bylbylit”; “I tretuni”; Poema “Andrra e jetës”; Poemat tingëllimore “Liria”, “Lissus”, “Scodra”.	3
12.	<b>Zef Skiroi</b> Poezitë atdhetare; Poemat lirike “Mili dhe Hajdhia”; Poemat heroike; Poema “Te dheu i huaj”; “Mino”, analizë e kësaj poeme.	3
13.	<b>Vinçenc Prenushi</b> Vëllimi poetic “Gjeth e lule”; Dramaturgjia e Prenushit; Përkthimet, publicistika, folkloristika.	3
14.	<b>Asdreni</b> Jeta dhe veprimtaria; Lirikat patriotike; Lirikat shoqërore; Motivi peisazhist; Motive meditative.	3
15.	<b>Ndoc Nikaj</b> Jeta dhe krijimtaria; Analizë e romanit “Marcja”; Analizë e romanit historik “Shkodra e rrethueme”; Analizë e romaneve tjera historike; “Tivari i marrun”, “Bukurusha”, “Ulqini i marrun”, “Bukurusha”.	3
	<b>Provimi i dytë gjysmësemestral</b>	

<b>LITERATURA</b>
<p><b>Literatura bazë:</b> Veprat e autorëve të përfshirë në këtë semestër Rexhep Qosja: <i>Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi 2, 3</i>, Rilindja, Prishtinë, 2010; Sabri Hamiti, “Letërsia filobiblike Letërsia romantike”, vepra 7. F. Konica, Prishtinë, 2002. Grup autorësh: <i>Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1989.</i></p> <p><b>Literatura shtesë:</b> Rexhep Qosja: <i>Porosia e madhe</i>, Rilindja, Prishtinë, 1986. Eqrem Çabej: <i>Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes</i>, MÇM, Tiranë, 1994. Robert Elsie: <i>Historia e letërsisë shqiptare</i>, Dukagjini, Pejë, 1997. Sali Bashota: <i>Domethënia e ideve letrare</i>, Rilindja, Prishtinë, 2001. Latif Berisha: <i>Vepra</i>, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2002. Sali Bashota: <i>Studime letrare</i>, Toena, Tiranë, 2008.</p>
<b>VËREJTJE</b>

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për "huazim" nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

**Vërejtje për studentin:**

*Studentët duhet t'u përmbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së, rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor Pritet që secili student të vijë me kohë dhe të marrë pjesë në çdo ligjeratë. Për shkak të natyrës dhe mënyrës së studimit në këtë lëndë, ardhja në mësim dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi, si dhe t'i shkyçin telefonat mobilë gjatë ligjëratave.*